


J. G. Pashaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Lënda: Amendament për projektligjin “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”

DREJTUAR: **Z. Gramoz RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BAZA LIGJORE: Rregullorja e Kuvendit, neni 75, pika 4

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, propozoj që në projektligjin “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” të bëhet shtesa e mëposhtme:

Pas shkronjës “k)” të Nenit 23, shtohet shkronja “l)” me këtë përmbajtje:

“l) Të informojë në mënyrë periodike familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike për të kryer deklarin e ndryshimeve të situatës social-ekonomike, çdo tre muaj”

DEPUTETI
Vullnet SINAJ

[Signature]

Ilir BEQAJ

RELACION

Nisma e qeverisë për të ndihmuar me të holla prindërit në rastin e lindjes së fëmijës/fëmijëve është mirëpritur.

Qëllimi i kësaj nisme është që të jepet një shtysë për t'u përballur me sfidën demografike me të cilën po ndeshet Shqipëria, por mendoj se duhet bërë dallim midis familjeve që jetojnë në Shqipëri dhe atyre që jetojnë jashtë vendit.

Duke dhënë shpërblim në të holla për familjet që jetojnë jashtë vetëm pse regjistrojnë në Shqipëri fëmijën nuk jepet ndonjë shtysë në përballjen me sfidën demografike.

Por, meqë mund të ndodhë që një fëmijë, edhe pse prindërit janë me banim të përhershëm në Shqipëri, të lindë jashtë vendit, propozohet kushtëzimi që gjatë shtatzanisë nëna të ketë jetuar 16 javë në Shqipëri (rreth 40 % të periudhës së shtatzanisë).

Deputet

Ilir BEQAJ

